



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORË

SHPLLJE PËR VEND TË LIRË PUNE
(Inspektor në Strukturën Përgjegjëse për Inspektimin e Mbrojtjes së Tokës në Këshillin e Qarkut Vlorë)

Në zbatim Ligjit Nr. 139, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar, Ligjit Nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, Ligjit Nr. 99/2024 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, nenit 15, pika 4 të Ligjit Nr. 87/2025 “Për buxhetin e vitit 2026”, Ligjit Nr. 8752, datë 26.03.2001 “Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për Administrimin dhe Mbrojtjen e Tokës” i ndryshuar, Ligjit Nr. 9244, datë 17.6.2004 “Për mbrojtjen e tokës bujqësore” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 80, datë 28.01.2005 “Për përbërjen, mënyrat e funksionimit, detyrat dhe përgjegjësitë e strukturave shtetërore të mbrojtjes së tokës bujqësore”, institucioni i Këshilli i Qarkut Vlorë njofton për 2 (dy) pozicione pune të lira :

Inspektor në Strukturën Përgjegjëse për Inspektimin e Mbrojtjes së Tokës në Këshillin e Qarkut Vlorë

kategoria IV, klasa IV –2

Lloji i diplomës “Shkenca në fushën e Ekonomisë/Gjeodezisë/Agronomisë”, niveli minimal i diplomës “Bachelor”

Përshkrimi përgjithësues i punës për këtë pozicionin është:

Inspektori në Strukturën Përgjegjëse për Inspektimin e Mbrojtjes së Tokës në Këshillin e Qarkut Vlorë është përgjegjës për:

- Sigurimin, respektimin dhe zbatimin e akteve ligjore dhe nënligjore në ushtrimin e funksioneve, detyrave, përgjegjësisive dhe kompetencave që i jepen me këto akte si dhe zbatimin e procedurave administrative në mbrojtjen e tokës bujqësore si dhe përdorimin e saj të qëndrueshëm si strukturë shtetërore e ngritur për këtë qëllim.
- Kryerjen e detyrave specifike për inspektorët, në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi për mbrojtjen e tokës bujqësore, dhe rehabilitimin e tokave të dëmtuara.
- Zbatimin e detyrave me qëllim realizimin me cilësi të punës, bashkëpunimi me aktorët e tjerë institucionalë si Komisioni i Mbrojtjes së Tokës në qark, Komisioni Shtetëror i Mbrojtjes së Tokës, Inspektoriati Shtetëror i Mbrojtjes së Tokës, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.
- Zbatimi i Plan-Veprimit, për ushtrimin e kontrolleve metodike, të zakonshme që organizohen nga IMT.
- Ushtrimi i kontrolleve në gjithë territorin e Qarkut Vlorë së bashku me pjesën tjetër të strukturës në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 9244, datë 17.06.2004 “Për mbrojtjen e tokës bujqësore” i



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORË**

ndryshuar dhe përgatitja e raporteve pas kontrolleve të ushtruara mbi masat për mbrojtjen e tokës bujqësore, dhe rehabilitimin e saj.

- Marrjen pjesë në komisione apo grupe pune të ngritura me urdhër të Kryetarit/Drejtorit/Kryeinspektorit.
- Kryerjen e detyrave të tjera përkatëse që i caktohen.

Për këtë pozicion kanë të drejtë të aplikojnë të gjithë kandidatët të cilët plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe të veçanta si më poshtë:

1. Kriteret të përgjithshme:

- Të jetë shtetas shqiptar;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale.

2. Kriteret të posaçme:

- Të zotërojnë diplomë të nivelit minimal **“Bachelor”** në **“Shkenca në fushën e Ekonomisë/Gjeodezisë/Agronomisë”** (*Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njësimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi*). **Preferohet, për shkak të detyrave dhe funksioneve të Strukturës Përgjegjëse për Inspektimin e Mbrojtjes së Tokës, diploma “Agronom”, “Gjeodet”.**
- Të kenë mbi 6 (gjashtë) muaj përvojë pune në administratën shtetërore dhe/ose institucione të pavarura.
- Të ketë aftësi të mira komunikuese dhe të punës në grup.

3. Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

- Kërkesë;
- Jetëshkrim
- Kopje të diplomës e noterizuar. Nëse aplikanti ka diplomë Master Profesional/ Shkencor, duhet të përfshihet edhe diploma Bachelor. (*Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njësimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi*).
- Listë notash;
- Kopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë) e noterizuar;
- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- Çertifikatën e gjendjes gjyqësore (dëshmi penaliteti);
- Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;
- Vlerësimin e fundit të punës;
- Vërtetimin nga prokuroria për qenien ose jo në ndjekje penale;



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORË**

- Vërtetimin nga gjykata për çështje në proces gjykimi;
- Vërtetimin që të mos ketë masë disiplinore të largimit nga puna që nuk është shuar ose të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;

Dokumentat duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti në institucion, Zyra e Sekretarisë/Protokoll – Arkivës brenda datës 25.05.2026, në adresë: Këshilli Qarkut Vlorë, Pallati i Kulturës “Labëria”, Kati i III –të , Vlorë.

Nëse dokumentacioni i dorëzuar nga aplikantët do të gjendet i plotë sipas kërkesave të mësipërme, lista me aplikantët fitues (kandidatët që plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe të veçanta) do të shpallet në faqen zyrtare të institucionit të Këshillit të Qarkut Vlorë, ku do të njoftohen mbi datën, orën dhe vendin e zhvillimit të intervistës me gojë.

Kandidatët që nuk i plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe të veçanta do të njoftohen individualisht (nëpërmjet adresës së e-mail) për shkaqet e moskualifikimit.

Kandidatët e kualifikuar nga vlerësimi i dokumentacionit do t'i nënshtrohen intervistës së strukturuar me gojë në lidhje me njohuritë mbi ligjet e mëposhtme:

- Ligjin Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar.
- Ligjin Nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”.
- Ligjin Nr. 9131 datë. 08.09.2003 “Për rregullat e Etikës në Administratën Publike”.
- Ligjin Nr. 8752, datë 26.03.2001, “Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për Administrimin dhe Mbrojtjen e Tokës”, i ndryshuar.
- Ligjin Nr. 9244, datë 17.6.2004, “Për mbrojtjen e tokës bujqësore”, i ndryshuar.
- VKM Nr. 80, datë 28.01.2005 “Për përbërjen, mënyrat e funksionimit, detyrat dhe përgjegjësitë e strukturave shtetërore të mbrojtjes së tokës bujqësore” i ndryshuar.